

**Në këtë numër**

<i>Të ardhurat nga vetë Albpetrol</i>	2
<i>Prodhimi i naftës për 2019</i>	3
<i>Organizimi strukturor i shoqërisë</i>	3
<i>Strategjia për blloqet e lira</i>	2
<i>Shtërbimet në funksion të prodhimit të naftës dhe mjedisit</i>	4

## PROGRAMI 2019, VIJIMI I RISTRUKTURIMIT, MË SHUMË INVESTIME PËR PRODHIMIN DHE MJEDISIN

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Albpetrol sh.a miratoi në fund të vitit që sapo lamë pas Programin Zhvillimor për vitin 2019. Për herë të parë ky program është ndërtuar pas një procesi të gjatë diskutimesh Brenda kompanisë, por dhe duke marrë në konsideratë analizën e punës për 9-mujorin e 2018. “Programi mbështetet në realizimet e treguesve kryesore të 9-Mujorit 2018 dhe siguron vijueshmërinë dhe përmirësimin e veprimeve operacionale të prodhimit të naftës dhe gazit, veprimeve për rristrukturimin e plotë organizativ, juridik, operacional e financiar të shoqërisë”, -



tha Administratori I Albpetrol sh.a, Kastriot Bejtaj gjatë prezantimit të programit për Këshillin Mbikëqyrës. Fokusi i këtij viti do të jetë optimizimi i

prodhimit të naftës dhe shfrytëzimi më i mirë i vendburimeve. Për herë të parë investimet në mjedis do të njohin një rritje të ndjeshme.

## ZERO SHKARKIME TË UJËRAVE NË BASENIN E LUMENJVE

“Zero shkarkime të ujërave teknologjike në basenin e lumenjve”. Ky është një nga zotimet e rëndësishme që ka marrë Albpetrol sh.a në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të një situatë problematike të trashëguar ndër vite. Për vitin 2019 në program janë parashikuar zëra të veçantë për: Investimet për

minimizimin e shkarkimeve të pakontrolluar të gazit shoqërues në ambient; investime në infrastrukturën fizike të naftës për eliminimin e shkarkimeve të pakontrolluara të naftës në ambient dhe ndotjes së pronave të komunitetit. Një nga investimet më thelbësore të parashikuara për 2019 është rikonstrukcioni i gropës

ekologjike Zharrëz, si një element tepër i rëndësishëm në përmirësimin e kushteve mjedisore dhe zgjidhjen përfundimtare të problemit në këtë zonë. Ndërkohë këtë vit do të vihet në zbatim një projekt pilot për evadimin e mbetjeve sabiore të krijuara në vite dhe eliminimi i një pjese të konsiderueshme të mbetjeve të rrezikshme.


## TË ARDHURAT NGA VETË ALBPETROL

*Rezultati financiar i shoqërisë është programuar për vitin 2019 në vlerën 29.144 milion lekë*

Te ardhurat e shoqërisë Albpetrol sh.a për vitin 2019 janë parashikuar të jenë 5,531,894 mijë lekë. Burimi i të ardhurave është kryesisht nga aktiviteti i vetë shoqërisë në nivelin 3,971,446,000 lekë. Këto

të ardhura përbëhen nga shitja e produkteve të vetë Albpetrol, 2,679,152,000 lekë dhe nga shërbimet që kryen vetë shoqëria (energji elektrike, investime, etj), 1,292,295,000 lekë. Ndërkohë nga zbatimi i Marrveshjeve Hidrokarbure janë parashikuar të ardhura në nivelin 1,560,448,000 lekë.

Në mënyrë më të detajuar të ardhurat parashikohet të jenë: Nga shitja e naftes janë parashikuar të ardhura 4,138,722,000 lekë. Nga shitja e Gazit janë parashikuar të ardhura 100,878,000 lekë. Nga shitja e energjisë elektrike janë parashikuar të ardhura 1,058,295,000 lekë. Nga kryerja e shërbimeve të tjera, investime etj, janë parashikuar të ardhura në vlerën 234,000,000 lekë.



## NDËRHJRJET E PLANIFIKUARA PËR 2019

*Në Programin e vitit 2019 janë parashikuar një sërë ndërhyrjesh të rëndësishme*

Në Programin e vitit 2019 janë parashikuar një sërë ndërhyrjesh të rëndësishme, por më thelbësoret janë tre: Shërbimi për kontroll periodik të pajisjeve nën presion, në zbatim të ligjit specifik për PNP-të dhe koalidimin e fikëseve të zjarrit, si masë

direkte në parandalimin e incidenteve apo aksidenteve tek punonjësit dhe mbrojtjen nga zjarret e mundshme; Pajisja me leje mjedisore në përshtatje me ligjin Nr. 10488, datë 14.07.2011, për vendburimet Gorisht-Kocul dhe Cakran- Mollaj; Pajisja e

punonjësve me mjete mbrojtëse kolektive dhe ato individuale (PMI). Ndërmasat konkrete në infrastrukturën e nxjerrjes, grumbullimit dhe transportit të naftës e gazit janë dedektorët e H2S, veshjet specifike për çdo profesion e aksesore të tjerë.

*Panaja, Frakull, Povelçë, Divjakë, Drashovicë, Ballaj-Kryevidh; dhe blloqet e kërkimit Adriatik 2, 3, 4; Veriu i Rodonit dhe Delvina*

## STRATEGJIA PËR BLOQET E LIRA


Aktualisht shoqëria "Albpetrol" sh.a ka nën administrim vendburimet e Panaja, Frakull, Povelçë, Divjakë, Drashovicë, Ballaj-Kryevidh si dhe blloqet e kërkimit Adriatik 2, Adriatik 3, Adriatik 4, Veriu i Rodonit dhe ai i Delvinës. Synimi për vitin 2019 është që këto blloqe të

promovohen më së miri. Drejtoria e Marrëveshjeve Hidrokarbure, në bashkëpunim me MIE do të vazhdojë punën për promovimin e vendburimeve të lira në administrim të Albpetrol sh.a, me synim lidhjen e Marrëveshjeve Hidrokarbure me investitorë që plotësojnë kushtet e

kapaciteteve teknike dhe financiare. Në bashkëpunim edhe me drejtoritë e Gjeologjisë, Prodhimit etj, do të finalizohen paketat e të dhënave me qëllim shitjen e tyre tek shoqëritë e interesuara për të aplikuar për lidhjen e Marrëveshjeve Hidrokarbure për vendburimet/blloqet që do të shpallen të lira nga MIE.

## PRODHIMI I NAFTËS PËR 2019

Për vitin 2019 prodhimi i naftës është programuar në nivelin 129,335 Ton, nga i cili 83,291 Ton është nga vetë Albpetrol dhe 46,044 Ton nga M-H. Krahasuar me prodhimin e pritshëm të vitit 2018, kemi një rënie me rreth 3,980 Ton. Prodhimi i naftës i programuar nga vet Albpetrol prej 83,291 Ton, për 2019 është parashikuar i ndarë si më poshtë: Nga 1176 puse ekzistues mesatar vitin 2019 do të merren 81,572 Ton naftë; Nga rivënia në punë e puseve të fondit të



ndalur do të merret prodhim 1009 Ton naftë; Nga riaktivizimi i puseve të ndalur në Amonicë do të

merren 365 Ton naftë; Nga riaktivizimi i 30 puseve me lugë do të merren 345 Ton naftë.

*Nga 1176 puse ekzistues mesatar vitin 2019 do të merren 81,572 Ton naftë; Nga rivënia në punë e puseve të fondit të ndalur do të merret prodhim 1009 Ton naftë*

## INVESTIMET STRATEGJIKE

Investimet strategjike për vitin 2019 do të fokusohen në 4 fusha kryesore. Më konkretisht investimet më të rëndësishme janë: Ndërtimi i RVM-së 200 m3 me sistem ngrohje në Q.17 në Cakran-Mollaj; Ndërtimi i sistemit të ngrohjes në RVM 700/1 Zharrëz dhe realizimi i sistemit të mbyl-

lur të trajtimit të ujrave teknologjikë; Rikonstruksion i plotë i Gr. 2 Amonicë; Rikonceptimi i ambienteve të punës të punonjësve me gabina të veçanta; Kompletimi i skemës teknologjike në Gr. 6 dhe Gr. 17 me sistemin e ndarjes së gazit në QPN Gorisht; Zëvendësim

pjesor të magjistrave të transportit të fluidit midis grupeve dhe stacioneve në vendburimin Cakran-Mollaj Riparim pjesor dhe pas-trim i RVM-së 5000/8 në Zharrëz. Riparimin e R.V.B në Gorisht dhe Cakran. Përmirësime të ambienteve të punës.

*Përmirësim të infrastrukturës të sistemit të grumbullimit, transportit dhe përpunimit të naftës*

## ORGANIZIMI STRUKTOROR I SHOQËRISË DHE KUALIFIKIMI I FUQISË PUNËTORE

Programi i Zhvillimit i vitit 2019 është konceptuar nga ana organizimit strukturor dhe fuqisë punëtore, si një vijim i procesit reformues që shoqëria ndërmori në vitin 2018. Ky proces është i nevojshëm për të harmonizuar aktivitetin e shoqërisë me një logjikë të shën-

doshë ekonomike si dhe për t'i dhënë Albpetrol sh.a formën dhe standartet e pranueshme të një shoqërie tregtare, bazuar kjo edhe në strategjinë qeveritare. Me realizimin e procesit të ristrukturimit përgjatë vitit 2018, shoqëria Albpetrol.sh.a është e organizuar në një

strukturë me 1.746 vende pune me 11 njësi organizative. Persa i perket programit të vitit 2019, në fokusin është rritja dhe kualifikimi profesional i stafit në disa nivele, testimin dhe kategorizimin tekniko-profesional të punonjësve, aplikimi i sistemit të menaxhimit të performancës.

*Albpetrol.sh.a është e organizuar në një strukturë me 1.746 vende pune me 11 njësi organizative*

www.albpetrol.al

Sella Qendrore: Rruga Fier-Patos,  
KM.7, Patos

Zyrat e përfaqësimit në Tiranë: Rr.  
Ibrahim Rrugova, Ndërtesa Sky Tower,

Email: [Info@albpetrol.al](mailto:Info@albpetrol.al)

**Kompania shtetërore  
e naftës në Shqipëri**

  
**Albpetrol sh.a**

## ZHVILLIMI I NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE OPERACIONALE

Për vitin 2019 shoqëria Albpetrol ka parashikuar të organizohet me 1790 vende pune sipas organogramës ekzistuese.

Qendrat e Prodhimit të Naftës do të vazhdojnë kryerjen e operacioneve hidrokarbure në bazë të strukturës ekzistuese në 3 qendra deri në fund të vitit 2019.

QASHNG, QFSHE, QEMNG dhe QAKP për vitin 2019 do të funksionojnë si qendra me vete dhe do të vazhdojnë të kryejnë aktivitetin e tyre, duke

përmirësuar standardin e proceseve të punës.

Shërbimi Gjeofizik, Uzina Mekanike Kuçovë dhe Qendra e Furnizimit dhe Transportit, për 6- Mujorin e I-rë, 2019 është programuar të funksionojnë si qendra më vete. Për 6-

Mujorin e II-të shoqëria do të marrë të gjitha masat për një rikonceptim të ri të shërbimeve që ato kryejnë dhe një riorganizim të këtyre qendrave me synim uljen e kostos dhe përmirësimin e cilësisë së kryerjes shërbimeve.



## SHËRBIMET NË FUNKSION TË PRODHIMIT TË NAFTËS DHE MJEDISIT

Gjatë vitit 2019 Albpetrol sh.a ka parashikuar një sërë shërbimesh në lidhje me përmirësimin e kushteve ambientale (mbetjet e rrezikshme, ndotjet hidrokarbure në kanalet e Zharrezes, mbetjet sabiore, mbetjet teknologjike në Usojë etj) në vlerën 63.9 milion Leke. Për vitin 2019 janë parashikuar 112.6 milion lekë për shërbimet teknologjike me sipërmarrje private. Ndërkohë 87.2 milion lekë shërbime do të jenë në funksion të pronës, kontraktimit të shërbimit privat për planet e rivelimt dhe dixhitalizimit të hartave topografike dhe ruajtjen e saj. 143 milion lekë do të jenë për



Gjatë diskutimeve të Programit të Zhvillimit 2019

transport punonjësish, garanci dhe suport të pajisjeve informatike, mirëmbajtje pajisjesh, marrje me qera tokë dhe zyra, etj. 255.5 milion lekë i përkasin pagesave të tatimit taksave dhe siguracioneve, si sigurim pasurie, jete, garanci doganore, taksat vendore, siguracion i

mjeteve etj. ku peshën kryesore e zënë taksat vendore në vlerën 163 milion lekë. Ngritja e kapaciteteve dhe strukturave të kompanisë Albpetrol për monitorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të vetë kompanisë dhe atyre përmes nënkontraktoreve jashtë saj.